



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e hënë, më datë 29 shkurt 2016 u zhvillua mbledhja e radhës e Autoritetit të Mediave Audiovizive në të cilën morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Z.Gentian Sala	Kryetar
Z.Sami Nezaj	Zëvendëskryetar
Z.Gledis Gjipali	Anëtar
Z.Piro Misha	Anëtar
Zj.Suela Musta	Anëtar
Z.Zylyftar Bregu	Anëtar

AMA pasi mori në shqyrtim çështjet e rendit e ditës, miratoi vendimet e mëposhtme:

1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të AMA-s datë 27.01.2016 dhe datë 01.02.2016.
2. Miratimin e raportit të Autoritetit të Mediave Audiovizive për veprimtarinë e zhvilluar gjatë vitit 2015.
3. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Digitalb” sh.a., për transferimin e të drejtave që burojnë nga licenca e shoqërisë “Super Sport” sh.a., tek shoqëria “Digitalb” sh.a.
 - ❖ Licenca Nr. 02/PNS dhënë shoqërisë “Super Sport” sh.a. bëhet e pavlefshme.
 - ❖ Përfshirjen e programeve të platformës numerike satelitore “Super Sport” në strukturën programore të platformës private numerike satelitore “Digitalb”.

Po ashtu, AMA mori në shqyrtim ankimet administrative ndaj sanksioneve më gjobë të vendosura nga Grupi i Inspektimit ndaj subjekteve audioviziv privat kabllor duke vendosur:

1. Pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e sanksionin me gjobë nr. 59, datë 11.12.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 2.000.000 (dy milion) lekë, ndaj subjektit person fizik Bilbil Hajdini, për subjektin kabllor “TV Fieri”.
2. Rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të sanksionin me gjobë nr. 60, datë 15.12.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 2.000.000 (dy milion) lekë, ndaj subjektit person fizik Bilbil Hajdini, për subjektin kabllor “TV Fieri”.

Tiranë, 29 Shkurt 2016